



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

14407/30

13.01.2025

UDHËZIM

Nr. 02, datë 13.01.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.5, TË DPD DATË 26.10.2018
“MBI PROCEDURAT STANDARDE TË FUNKSIONIMIT TË SEKTORIT TË
VLERËSIMIT QËNDOR DHE SEKTORIT TË KONTROLLIT APOSTERIOR OPERATIV”**

Në mbështetje të neneve 10, 47, dhe 51, të ligjit nr.102, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës 1(b)(i), të Pjesës VIII/1, të vendimit nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, me qëllim përshtatjen me strukturën e re të miratuar me VKM Nr.355, datë 26.5.2022 “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.5, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, datë 26.10.2018 “Mbi procedurat standarde të funksionimit të Sektorit të Vlerësimit Qëndor dhe Sektorit të Kontrollit Aposterioer Operativ”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Kudo në udhëzim ku përmenden fjalët “Sektori/Sektorit/dhe Sektori/dhe Sektorit i/të Kontrollit Aposterioer Operativ (SKAO)”, hiqen;
2. Në pjesën I, bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a) Shfuqizohen pikat 3, dhe 4;
 - b) Pikës 5, i ndryshon numeracioni në 3, dhe riformulohet, si më poshtë:
“Përqindja e deklaratave të pranuar në sistem me qëllim rikontrollin kryhet në bazë të ngarkesës si dhe elementëve të riskut. Kriteret e përzgjedhura përcaktohen nga Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Riskut”;
3. Në pjesën II, bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a) Në pikën 1, hiqet fjala “blu”;
 - b) Në pikën 3, fjalia e parë riformulohet si më poshtë:
“Deklaratat e përzgjedhura në kanalin jeshil mund të rikanalizohen në kanal tjetër me nivel më të lartë risku”;

4. Në pjesën III, pika 1, nënpika 1.5, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

a) Në shkronjën a), paragrafi a.2), në fund të paragrafit, shtohen fjalët “me shkresë ose në rrugë elektronike (e-mail)”;

b) Në shkronjën b), paragrafët b.1) deri b.7), ndryshohen si më poshtë:

“b.1) prova e origjinës të jetë lëshuar në momentin e eksportit ose kur eksporti është siguruar. Vërtetimi i origjinës preferenciale është i vlefshëm për katër muaj nga data e lëshimit në palën eksportuese bazuar në Konventën Rajonale për rregullat e origjinës pan-Euro-Mesdhetare si dhe Marrëveshjen e Partneritetit dhe Bashkëpunimit Tregtar me Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut, ose për 10 muaj bazuar në Konventën pan-Euro-Mesdhetare, të ndryshuar, dhe duhet depozituar brenda këtyre periudhave tek autoritetet doganore;

b.2) Formulari i certifikatës EUR.1 i cili mund të jetë hard-copy ose i lëshuar në mënyrë elektronike duhet të përmbushë kushtet e parashikuara në protokollin përkatës të rregullave të origjinës preferenciale në fuqi;

b.3) Te krahasohen vulat e Certifikatave të Origjinës EUR.1 (në kutinë nr.11) me specimenet e përcjella nga doganat homologe apo Komisioni Evropian. Në rastin e certifikatave elektronike të shihet Matriksi i publikuar nga KE në lidhje me shtetet që lëshojnë certifikata elektronike EUR. 1 dhe datën e fillimit të lëshimit të tyre;

b.4) Nëse prova e origjinës është një deklaratë-origjine nga një eksportues i thjeshtë, të verifikohet vlera e produkteve origjinuese pasi nuk duhet t'i kalojë 6,000 (gjashtë mijë) Euro;

b.5) Nëse deklarata-origjinë është dhënë nga një eksportues i autorizuar nga autoritetet doganore të verifikohet formati i numrit të autorizimit me modelet e përcjella nga doganat homologe apo Komisioni Evropian;

b.6) Në rastet e deklaratave-origjinë të lëshuara nga eksportuesit, duhet të sigurohet që teksti i deklaramit të origjinës, në faturë apo në ndonjë dokument tjetër tregtar, të jetë sipas aneksit përkatës të protokollit të rregullave të origjinës, si dhe të verifikohet firma origjinale e eksportuesit pasi duhet të jetë e shkruar me dorë (përjashtim nga firma origjinale bën eksportuesi i miratuar, i cili mund të mos i nënshkruajë këto deklarata);

b.7) Nëse operatori ekonomik ka në praktikën doganore një vendim Informacioni Detyrues të Origjinës (IDO) të plotësohet kodi shtesë përkatës në sistemin Asycuda World në rubrikën përkatëse të DAV.”;

c) Në shkronjën b), paragrafi b.9) shfuqizohet;

ç) Në shkronjën b), shtohet paragrafi b.10), si më poshtë:

“b.10) Nëse ka dyshime në lidhje me autenticitetin e provës së origjinës apo origjinën e mallrave të mbuluara prej tyre, të dërgohet prova përkatëse pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës me qëllim nisjen e procedurës së verifikimit pranë doganës përkatëse homologe. Nëse dyshimet janë për autenticitetin dërgohet prova e origjinës origjinale”;

d) Në shkronjën e), paragrafi e.3), bëhen ndryshimet si më poshtë:

Fjalët “specialisti/koordinatori me DPD apo në Përgjegjësi i Zyrës/Turnit/Pikës dhe specialisti përkatës pranë kryetarit të Degës Doganore (për Degët Doganore që nuk kanë specialist/koordinator me DPD)” zëvendësohen me fjalët “doganieri përkatës konsultohen me bazën e të dhënave të shkeljeve doganore për të verifikuar nëse personi ka shkelje të mëparshme dhe”;

5. Në pjesën III, pika 2, nënpika 2.10, shkronja a), paragrafi a.3), pas fjalëve “doganieri i kontrollit fizik” shtohen fjalët “konsultohen me bazën e të dhënave të shkeljeve doganore për të verifikuar nëse personi ka shkelje të mëparshme dhe”;

6. Pjesa "IV)" shfuqizohet;
7. Në pjesën "V)" bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 1, hiqen fjalët "(Aposterior Operativ 5 ditor)";
 - b) Në pikën 2, fjalët "...personeli doganor i SVQ dhe SKAO bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë..." zëvendësohen me fjalët "...personeli doganor i SVQ bashkëpunon dhe ndërvepron...";
8. Në pjesën "VI)" pika 1, hiqen fjalët "dhe SKAO";
9. Në "Formularin mbi Rivlerësimin Doganor për Automjetet Kodi (8703)" hiqet kutia "Aposteriori (5 ditor)";
10. Në "Formularin mbi Rivlerësimin Doganor" hiqet kutia "Aposteriori (5 ditor)";
11. Ky udhëzim hyn në fuqi me datë 14 / 01 / 2025.

Ndryshimet në pjesën III, pika 1, nënpika 1.5, shkronja b), paragrafët b.1) deri b.7) dhe paragrafi b.10, të udhëzimit nr.5, të DPD, datë 26.10.2018, të parashikuara në pikën 4, shkronja "b" të këtij udhëzimi, hyjnë në fuqi me datë 1 janar 2025.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE

Genti Gazheli

